



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samupravo
Ministry of lokal government Administration

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shërbyesit Civil Nr. 03/L-149, shpall :

KONKURS

Titulli i postit: Zyrtar për Bashkëpunim me Qendrat dhe Institucionet e Mirëqenies

Njësia: Drejtorati për Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi, Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut (ZAMV)

Niveli i pagës/gradës :

Orari: 40 orë në javë

Raporton tek: Drejtori i Drejtoratit për Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi, ZAMV

Referenca:

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

1. Është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria;
2. Kryen shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre përmes aktiviteteve të qendrës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari;

3. Marr hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre;
4. Përgatit plane vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mban shënime e statistika dhe raportin për aktivitetet në fushë të shërbimeve sociale dhe familjare çdo vit, si dhe në çdo interval tjetër kohor, sipas kërkesës së MPMS;
5. Në mënyrë që të promovohet përfshirja e komunitetit, transparenca dhe llogaridhënia, publikon planin dhe raportin e tij vjetor;
6. Gjatë përgatitjes së planeve të tyre vjetore konsultohen gjerësisht me shfrytëzuesit e shërbimeve sociale dhe familjare, përfaqësuesit e tyre, organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera relevante të komunitetit dhe grupet profesionale në territorin e tyre në lidhje me zhvillimin, planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare;
7. Siguron që qendra për punë sociale në territorin e vet të ketë resurse sipas standardeve të specifikuara nga Ministria;
8. Nëpërmes QPS-ve dhe organizatave joqeveritare të sigurojnë ose mundësojnë ushtrimin e shërbimeve shtesë që vijojnë: ndihmë në punët e shtëpisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, pastrimin, gatimin e ushqimit dhe larjen e rrobave për individët, të cilët për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar ose sëmundjes, nuk mund të kryejnë këto punë për veten ose të cilët nuk kanë familje apo ndonjë ndihmë tjetër; përkujdesje të drejtpërdrejtë personale të individëve në shtëpinë e tyre, duke përfshirë por pa u kufizuar me veshjen e rrobave, larjen, higjienën personale, ndihmën për të lëvizur dhe për t'u ngritur, cilët, për shkak të moshës, aftësive të kufizuara ose sëmundjes, nuk mund të kryejnë vetë këto punë ose nuk kanë familje apo ndonjë ndihmë tjetër në dispozicion; hapja e një qendre, ku individët në nevojë mund të mblidhen çdo ditë për t'u shoqëruar e ushqyer, për të mbajtur higjienën personale, për të zhvilluar terapinë e punës dhe çfarëdo aspekti tjetër të këshillimit dhe përkujdesjes sociale; shërbime specialistike të këshillimit për njerëzit me varësi ose probleme të tjera psiko-sociale;
9. Asistencë me anë të përkrahjes financiare, sigurimit të lokalit ose këshillës profesionale për grupet e njerëzve në nevojë ose ata që kujdesen për ta në mënyrë që të krijojnë dhe mbajnë grupe për ndihmë reciproke dhe grupe për vetë ndihmë;
10. Përkujdesje rezidenciale për të moshuarit dhe njerëzit me nevoja të posaçme;

11. Bën përgatitje adekuate për t'u përgjigjur në rastet e shërbimeve urgjente sociale dhe familjare të cilat kërkojnë jashtë orarit të rregullt të punës;
12. Me lejen e Ministrisë, mund të sigurojnë bashkërisht shërbime specialiste ose shërbime të tjera sociale dhe familjare në territoret e tyre.
13. Përgatit raporte për Drejtorin;

Kryen punë tjera me kërkesë të Drejtorit të Drejtoratit;

Aftësitë dhe shkathtësitë:

- Diplomë Universiteti-fakulteti në lëmin e Sociologjisë, Shëndetësisë apo fusha tjera relevante.
- Përvojë pune në fushat relevante, preferohet te ketë përvojë pune menaxheriale;
- Njohuri bazike mbi legjislacionin e pushtetit lokal dhe fushës profesionale;
- Shkathtësi të dëshmuara në të menduarit strategjik, aftësi të planifikimit, shkathtësi në aplikimin e planeve dhe punës në grup;
- Aftësi për punë në mjedis multi-etnik;
- Aftësi për punë nën presion;
- Aftësi të mira ndër njerëzore dhe mbajtja e kontaktit me personat të cilët marrin vendime;
- Njohja e gjuhëve zyrtare, ndërsa njohja e gjuhës angleze do të merret si përparësi;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme komunikimi;

Kualifikimi dhe përvoja:

- Diplomë Universiteti-fakulteti në lëmin e Sociologjisë, Shëndetësisë apo fusha tjera relevante.
- Përvojë pune në fushat relevante, preferohet te ketë përvojë pune menaxheriale;
- Njohuri bazike mbi legjislacionin e pushtetit lokal dhe fushës profesionale;
- Njohuri të mira të punës me kompjuterë (me aplikacionet Microsoft, internet etj.);

Proceduara e aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren në Zyret e Ekipit Pergaditor per Mitrovicën e Veriut dhe Qendrën për Shërbime të Qytetarëve në Lagjen e Boshnjakëve, ose në adresën elektronike <http://kk.rks.gov.net/mnao/> Numri kontaktues 038-200 35 084; 038/200 35 082 prej orës 08:00 deri 16:00, çdo ditë pune.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do merren në shqyrtim nëse arrijn brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën, certifikata e shtetësisë dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur në listën e ngushtë dhe të ftuar në intervistë doemos duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale si dhe të kenë me vete kartën e identitetit (letërnjoftimin).